



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202000018/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e bërë në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.2, Tiranë.*

**Drejtuar :** **Kryekomisar Olti BISTRË**  
Shef i Komisarariatit të Policisë Nr.2

**TIRANË**

**Për djeni:** **Drejtues i Parë Rebani JAUPI**  
Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

**TIRANË**

*I nderuar z.Bistri,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>1</sup>, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Nr.2 Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 03.12.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj.Ermonela Xhafa me detyrë Komisionere e Mekanizmit Kombëtar, z.Besnik Deda dhe znj.Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

---

<sup>1</sup> Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë nr.2, z.Olti Bistri, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, z.Bistri informoi grupin e inspektimit për gjendjen në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë pranë këtij komisaritati, angazhimin e punonjësve të policisë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Gjithashtu, shefi i komisarariatit angazhoi shefin e krimeve, punonjësit e policisë të zyrës së informacionit në ambientin e shoqërimit, si dhe përgjegjës të dhomave të sigurisë, që të ishin prezent gjatë inspektimit për evidentimin e kushteve të ambjenteve ku mbahen dhe trajtohen personat e privuar nga liria në këtë komisarariat.

Grupi i monitorimit, inspektoi në vend ambientet e shoqërimit dhe ato të sigurisë të komisarariatit, zyrat e punës të oficerëve të policisë gjyqësore që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, si dhe u njoh e administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit, zhvilloi dhe intervista konfidenciale me personat ndaluar/arrestuar që ndodheshin në mjediset e policisë të komisarariatit, në kohën e inspektimit.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi mëparshëm, rezultoi se:

1. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për sigurimin e ngrohjes në dhomat e sigurisë, duke vendosur paisje elektrike në periudhën e dimrit.
2. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për riparimin e kamerës që ndodhej në koridorin e ambientit të sigurisë.
3. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për riparimin e gjeneratorit i cili shërben si burim alternativ për furnizim me energji elektrike të dhomave të sigurisë, dhomave të shoqërimit dhe ambjenteve të tjera të institucionit.

Ndërkohë, **grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:**

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar apo shoqëruar, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës (zyrës) të posaçme për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin, i cili duhet të jetë një ambient i përshtatshëm, i pajisur me orëditë e nevojshme dhe mjete didaktike, për zhvillimin e bisedave miqësore me këtë kategori të personave.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisarriatin e Policisë Nr.2 në Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarriatin e Policisë nr.2 Tiranë, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>2</sup>

Mjedisi i shoqërimit kishte 3(tre) dhoma shoqërimi për mbajtjen dhe qëndrimin e shtetasve të rritur, femra dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit ishin me dimensione 4x3m, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme dhe të pajisura me tavolina e karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhomat ishin të mbyllura dhe të siguruara me çelës.

Ambientet e shoqërimit në këtë komisarriat, nuk janë në përputhje me parashikimet e akteve normative të nxjerra për këto qëllime. Në çdo rast, brenda hapësirës infrastrukture të godinës ishte përshtatur sipërfaqja me numrin e personave që duhet të akomodohen në të. Kapaciteti fizik i dhomave, ishte për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 5 personave të shoqëruar, për secilën dhomë.

Dritaret e dhomave krijojnë mundësi për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe sigurojnë ndriçim nga rrjeti elektrik. Dhomat ishin pastra nga ana higjieno sanitare, por kishin nevojë për lyerje. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë teli, për arsye të sigurisë të personave që ndodhen në këto ambiente.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë më vete për marrjen në pyetje/ intervistimin e shtetasve. Në çdo rast, intervistimi i personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Kryerja e veprimeve procedurale dhe komunikimi i masës së sigurisë të personave dhe kalimin nga ambienti i shoqërimit për në dhomat e sigurisë, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Mjedisi i shoqërimit dhe zyrat e punonjësve të policisë, nuk janë të monitoruara me sistemin e kamerave.

---

<sup>2</sup> *Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

Ngjitur me dhomat e shoqërimit, ndodhej një tualet i përbashkët për personat meshkuj dhe femra, i pajisur me mjetet e duhura hidrosanitare dhe kishte ujë të rrjedhshëm.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në kohën e inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e policisë të këtij komisariati.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin dhe dhomat e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë nr.2 në Tiranë, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar.

Nga verifikimi i dokumentacionit në zyrën e informacionit, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika, nga ku rezultoi se në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisarariatin e Policisë nr.2 Tiranë, mbahej procesverbali përkatës dhe pasi firmosej një kopje i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje ruhej në arkivën e institucionit.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisarariatin e Policisë nr.2 në Tiranë, ambienti i sigurisë nuk ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës së komisarariatit dhe kishte 2 (dy) dhoma sigurie. Dhomat e sigurisë ishin me përmasa 3x3m dhe nuk plotësojnë normat jetësore dhe të sigurisë së dhomave për një të arrestuar/ndaluar. Në kohën e inspektimit, në këto ambiente ndodheshin 2 persona të arrestuar. Këto dhoma përdoren vetëm për mbajtjen dhe sigurimin e personave të ndaluar/arrestuar në moshë madhore.

Në rastet e ndalim/arrestimit të personave femra dhe të mitur, në përfundim të procedurave nga punonjësit e policisë, ata dërgohen menjëherë në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Nisur nga kushtet në të cilën ndodhen dhomat e sigurisë në këtë komisarariat, asnjë nga dhomat e sigurisë nuk i plotësojnë parametrat teknikë për ndërtimin e tyre. Në procedurat standarde parashikohet se, dhomat e sigurisë duhet të garantojnë “qëndrim dhe jetesë normale” të personave të ndaluar/arrestuar. Bazuar në kriteret e ndërtimit të dhomave të sigurisë, sipërfaqe e përgjithshme për një të arrestuar/ndaluar duhet të jetë jo më pak se

10 m<sup>2</sup>, e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>3</sup>

Gjatë inspektimit, u konstatua se dhomat e sigurisë nuk ishin të pajisura me krevatë për fjetje. Personat e ndaluar/arrestuar që ndodheshin në këto dhoma, ishin të pajisur me batanie dhe jastek, ndërsa dyshekët shtroheshin në dyshemenë prej dërrase, të cilët ishin të vjetëruar dhe të amortizuara. Dritaret e dhomave të sigurisë, në kushtet aktuale mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit, por jo të dritës natyrale. Nisur nga ky konstatim, rezultoi se nga ana e sektorit të shërbimeve mbështetëse në këtë komisariat, duhet të merren masa të vazhdueshme për të përmirësuar pajisjen me sende higjieno personale, në mënyrë të veçantë kur të ndaluarit nuk kanë të afërm të cilet tu sjellin sende të tilla, si peshqire apo çarçafë për të shtruar në këta dyshek, siç përshkruhet më sipër.

MKPT e konsideron si problematike kapacitetin që ofrojnë ambientet e Komisarariatit Nr.2, i cili është i pamjaftueshëm, veçanërisht në rastet kur ka fluks personash të ndaluar dhe të shoqëruar dhe ndërkohë që masat e vlerësimit të dhëna nga gjykata janë “arrest me burg”.

Për këtë të fundit, grupi i inspektimit konstatoi se, kërkesat nga ana e organit të policisë për transferimin e personave të dënuar me vendim të formës së prerë apo me masë sigurie “arrest në burg”, për në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, kryhej menjëherë brenda ditës në përfundim të procedurave të verifikimit nga ana e tyre. Ndërsa, nga ana Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kishte vonesa në ekzekutimin e këtyre vendimeve penale sa më parë, sikurse përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale, çka është gjetur edhe si një shkelje nga ana e CPT (European Committee for the Prevention of Torture), në raportin e fundit të botuar për Shqipërinë.<sup>4</sup>

Në këtë raport, rekomandohet se *“Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje për t'i dhënë fund praktikës së mbajtjes në arrest policor të personave me masë sigurie "arrest në burg" dhe të dënuarit me burgim me një vendim të formës së prerë”*.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, institucionet shtetërore përgjegjëse Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 “Për transferimin në IEVP të të ndaluarve me masën e sigurisë “paraburgim” dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë, ku përcaktohen procedurat dhe afatet për transferimin e këtyre personave jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit<sup>5</sup>. Por, sikurse rezultoi nga kontakti me drejtuesit e policisë në nivel Drejtorie dhe komisariati, ky shqetësim vazhdonte të ishte prezent dhe marrëveshja e bashkëpunimit, ende nuk kishte gjetur zbatim në praktikë

Për këtë shkak, qëndrimi i personave në këto kushte për një periudhë tej afateve ligjore, nuk arrin të përmbushë standardin e trajtimit njerzor e me dinjitet të personave të ndaluar apo arrestuar sipas parashikimit të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga intervistimi i personave që ndodheshin në dhomat e sigurisë, rezultoi se ata ishin të furnizuar me paketën higjieno-sanitare.

<sup>3</sup> Kreu VIII, pika 3/3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

<sup>4</sup> Raporti CPT botuar më 17 shtator 2019. <https://rm.coe.int/168097986b>

<sup>5</sup> Rekomandimi 1, faqe 8, përgjigje e Qeverisë Shqiptare në lidhje me rekomandimet e CPT. <https://rm.coe.int/16809cb571>

Në ambientin e sigurisë ndodhej vetëm një tualet, i cili kishte furnizim me ujë të rrjedhshëm dhe një dush me ujë të ngrohtë për larjen e trupit.

MKPT vazhdimisht ka konstatuar se qëndrimi i personave të ndaluar dhe të shoqëruar në këto kushte, kërkon kujdes të veçantë pasi vë në rrezik edhe shëndetin e tyre dhe mund të jetë burim vatrash infeksioni dhe sëmundjesh, ndaj për rrjedhojë sugjeron të tregohet kujdes i veçantë në drejtimin e ruajtjes së higjienës brenda ambjenteve.

Në ambientet e sigurisë ishte edhe një dhomë e cila përdorej për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga prokurori apo oficerët e policisë gjyqësore, si dhe për takime me avokatët.

Njëkohësisht, kjo dhomë përdorej dhe nga mjeku për kryerjen e vizitave mjeksore të personave të arrestuar/ndaluar. Ajo ishte e pajisur me orendi si tavolina për punë, karrige për qëndrimin ulur të personave të arrestuar/ndaluar, një krevat për kryerjen e vizitave mjeksore dhe një raft për mbajtjen e medikamenteve bazë dhe kartelat mjeksore të personave të arrestuar që plotësoheshin nga mjeku.

Ndërkohë, këto ambiente për vetë funksionin që ato kanë, duhet të jenë të ndara më vete, sikurse përcaktohet edhe në procedurat standarde.

Ambientet e dhomave të sigurisë nuk kishin sistem qëndror ngrohjeje dhe ftohjeje. Por, për periudhën e dimrit, komisariati kishte marrë masa për kompletimin e dhomave me pajisje elektrike për ngrohje.

Në koridorin e ambientit të sigurisë, kishte një telefon fiks për komunikimin e personelit të shërbimit me sallën operative në rast nevojë, ndërsa në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile/sinjal për komunikimin e personave të ndaluar/arrestuar me personelin e shërbimit.

Ambienti i sigurisë në këtë komisariat, ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare, por kishte nevojë për lyerje dhe dezinfektim të herë pas herëshëm të këtyre ambjenteve.

Gjithashtu, u konstatua se, komisariati kishte një gjenerator për furnizimin me energji elektrike të dhomave të sigurisë, në rast të ndërprerjes të energjisë elektrike dhe ishte në gjendje pune. Sistemi i kamerave që mban në vëzhgim korridorin dhe hyrjet e dhomave të sigurisë, funksiononte rregullisht.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret, në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr.2 në Tiranë ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar. Në korridorin midis dhomave të sigurisë, ishin të afishuara lista prokurorisë me emrat dhe kontaktet e avokatëve, si dhe lista e personave që kanë të drejtë të hyjnë në këto ambiente të miratuar nga drejtuesi i komisarariatit.

Sa më sipër, nisur nga problematikat infrastrukture dhe kushtet higjieno-sanitare të konstatuara nga ana jonë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të këtij komisariati, rezulton se ekzistojnë ende problematika të përmendura edhe në raportin e CPT (European

Committee for the Prevention of Torture), gjatë vizitës të fundit monitoruese të mbajtur nga data 20 deri 30 Nëntor 2018 në Shqipëri<sup>6</sup>.

Në këto kushte, vlerësojmë hapat e ndërmarrë nga Policia e Shtetit për ndërtimin e objektit/bllokut të sigurisë për Drejtorinë/komisariatet e policisë Tiranë, sipas edhe angazhimit të qeverisë shqiptare në përgjigje të rekomandimeve të CPT. Por, inkurajojmë përfundimin e punimeve nga ana e operatorit ekonomik, që ka marrë përsipër ndërtimin e këtij objekti brenda 24 muajve, sipas afatit kontraktor lidhur me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë<sup>7</sup>.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, çdo njësi policore që ka dhoma sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

Komisariati i Policisë nr.2 Tiranë, ishte i plotësuar me të gjithë regjistrat e përcaktuar në procedurat standarde. Ata mbaheshin në një raft në dhomën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë dhe ishin të sekretuar e plotësuar sipas rubrikave.

Gjatë inspektimit u konstatua se edhe “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” konform me procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky regjistër mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

*Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se:*

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>8</sup>.

Në këtë komisarjat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e policisë të këtij organi.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

---

<sup>6</sup> Rekomandimi 8, faqe 14, përgjigje e Qeverisë Shqiptare në lidhje me rekomandimet e CPT. <https://rm.coe.int/16809cb571>.

<sup>7</sup> Kontrata Nr.1412, datë 14.08.2019 me operatorin ekonomik "HASTOCI" shpk për ndërtimin e zonës së Sigurisë në DVP Tiranë.

<sup>8</sup> Kreu VII, Procedurat standarte “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Nga kqyrja e librave të evidentimit të personave të ndaluar/ arrestuar dhe procesverbaleve, nuk kishte mospërputhje mes kohës (orës) kur ishin ndaluar apo arrestuar, me orën e shënuar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë.

Ndërkohë, në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2019 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga ana e këtyre personave.

### **Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.**

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Nr.2 në Tiranë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë ishin 2 (dy) persona të arrestuar.

Grupi i inspektimit intervistoi personat e ndaluar/arrestuar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet proceduriale. Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik brenda ambienteve të këtij Komisarjati, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm, sikurse përcaktohet në neni 133 të Ligjit nr. 108, datë 31.07.2014“Për Policinë e Shtetit”, VKM nr. 293, datë 8.4.2015 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuro-paralizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga policia e shtetit”, Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për miratimin e procedurave standarde të Departamentit të Sigurisë Publike “Për përdorimin e forcës”, si dhe në Procedurën Standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.<sup>9</sup>

Nga të intervistuarit nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për ndonjë pasojë të shkaktuar nga keqtrajtimi. Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre. Në lidhje me interesimin e grupi të inspektimit për kushtet e qëndrimit në dhomat e sigurisë, personat e arrestuar u shprehën se, ato nuk plotësonin kushtet minimale të jetesës, të ajrimit dhe të fjetjes

Koha e qëndrimit të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor. Të ndaluarve/arrestuarve, në këtë komisariat, u mundësohej trajtimi me ushqim 3(tre) herë në ditë, me shërbim katering sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në

---

<sup>9</sup> *Kreu XII, pika 2 Procedura Standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*



Vendimin Nr. 189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat me të cilin ishte lidhur kontratë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarriatin e Policisë Nr.2 Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet proceduriale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me kamera. Nga monitorimi që u bë zyrave të punonjësve të policisë në këtë komisarriat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale.

Ndërkohë, siç e përmendëm edhe më lart, në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar.

Lidhur me këto fakte, Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por është konstatuar se ky rekomandim nuk është plotësuar<sup>10</sup>.

Proçesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Gjithashtu, u konstatua se në Komisarriatin e Policisë Nr.2 Tiranë, nuk ka dhomë më vete për biseda apo intervistim me persona të mitur në konflikt me ligjin. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtërngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të fëmijët.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

---

<sup>10</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Në këtë komisariat, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Nga inspektimi, ezultoi gjithashtu se, ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Gjatë inspektimit u konstatua se, personat e ndaluar/arrestuar madhor ishin të njoftuar që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, të kërkonin ndihmë juridike për t’ju ofruar një avokat kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Gjithashtu u konstatua se në këtë komisariat, për rastet e shtetasve të huaj ju ofrohej dhënia e deklaratës në 6 gjuhë të huaj, ku parashikoheshin të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.

Përsa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/arrestuarve, u konstatua se ky shërbim ofrohej nga mjeku i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Nga kqyrja e dokumentacionit për secilin person të ndaluar/arrestuar rezultoi se, ishin kryer vizitat mjekësore brenda afatit 12 orësh.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme në Komisaratin e Policisë Nr.2, Tiranë, për sigurimin e kushteve të përshtatshme të qëndrimit dhe jetesë normale të shtetasve të ndaluar/arrestuar, që të plotësojnë standardin e trajtimit njerzor e dinjitoz të parashikuar nga konventa, pajisjen e dhomave të sigurisë me krevat brenda kapacitetit

të tyre fizik, si dhe lysterjen dhe dezinfektimin e ambientit të sigurisë, deri në ndërtimin e godinës/bllokut të dhomave të sigurisë për strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

2. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar apo shoqëruar, nga oficerët e policisë gjyqësore gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
3. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrës më vete për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambjent të përshtatshëm dhe të kompletuar me orëditë e nevojshme, për zhvillimin e intervistave me fëmijët e mitur.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore, të kompletuar me orëditë e nevojshme, si dhe frigorifer për ruajtjen dhe sigurimin e medikamenteve.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**